



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:185968
Datë: 27.03.2024
Numri i dokumentit: 05509192

C.nr.2013/2007

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Argzon Muçaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Rr.S. nga fshati M., Komuna e O., i përfaqësuar nga avokat G.K. sipas autorizimit të dhënë nga Agjencia për Ndhmë Juridike Falas, kundër të paditurës K., me objekt kontesti ndryshimi i aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë lidhur me rentën e arritur për pagesë dhe ndryshimin e rentës së gjykuar, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor publik në prani të paditësit dhe të autorizuarit të tij dhe të autorizuarit të paditurës, me datë 26.03.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit Rr.S. nga fshati M., Komuna e O.

II. DETYROHET e paditura K. që paditësit në emër të rentës mujore të arritur për periudhën 01.01.2000 deri me datën 28.02.2003 t'ia paguaj shumën prej 3,502.00 euro dhe në emër të kompensimit për përkuqdesje dhe ndihmë tjetrit për periudhën 01.01.2000 deri me datën 28.02.2003 t'ia paguaj shumën prej 2,872.00 apo shumën e përgjithshme prej 6,374.00 euro sipas kamatës e cila vlen për mjetet e depozituara në bankë me tepër se një vit pa destinim të caktuar nga data 13.03.2003 e deri në pagesën e tërësishme, e të gjitha në afat prej 15 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

III. NDRYSHOHET pika III dhe IV e dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë C.nr.986/01 i datës 13.03.2003, ashtu që, **DETYROHET** e paditura K. që paditësit t'ia paguaj në emër të kompensimit të rentës vijuese në të ardhmen, shumën në lartësi prej 324.75 euro në muaj si dhe kompensimin në emër të përkuqdesjes nga personi tjetër në të ardhmen, shumën në lartësi prej 266.30 euro në muaj, duke filluar nga data 22.02.2024, dhe atë çdo muaj deri me datën 5 të muajit, për muajin paraprak, deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore.

IV. REFUZOHET si e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadiës së paditësit me të cilën ka kërkuar që t'i njihet e drejta e shpërblimit në lartësi prej 58,899.75 euro, e arritur si rrjedhojë e ndryshimit të rrethanave ekonomike nga periudha e paraqitjes së padisë me datë 08.10.2001 deri me 31.10.2023 dhe atë 32,362.50 euro për rentën vijuese dhe 26,537.25 euro për përkuqdesje të personit tjetër.

V. Secila palë i bartë për vete shpenzimet e procedurës.

A r s y e t i m

Paraqitja e padisë dhe rrjedha e procedurës

Paditësi Rr.S. nga fshati M., Komuna e O., me datën 08 Tetor 2001 ka paraqitur padi në ish Gjykatën Komunale në Prishtinë, kundër të paditurës K., me të cilën ka kërkuar ndryshimin e aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë C.nr. 850/96 i datës 15.01.1997 lidhur me rentën e arritur për pagesë dhe ndryshimin e rentës së gjykuar.

Gjykata Komunale në Prishtinë me aktgjykimin C.nr.986/01 i datës 13.03.2003 e ka aprovuar të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke ndryshuar dhe shfuqizuar aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Komunale në Prishtinë C.nr. 850/96 të datës 15.01.1997, në pjesën që ka të bëjë me shumën e gjykuar për rentën mujore në të ardhmen si dhe në pjesën e cila ka të bëjë me shumën e gjykuar në emër të përkujdesit dhe ndihmës për personin tjetër, po ashtu, edhe rentën e arritur për pagesë, duke e detyruar të paditurën që të paguaj:

I. në emër të rentës mujore të arritur për periudhën nga dt. 01.01.2000 deri më datë 28.02.2003 shumën prej 3.502,00 euro me kamatë të cilën Banka e Re Kosovës e paguan për mjetet e destinuar për 12 muaj nga data 01.10.2001 e deri me pagesën e plotë.

II. në emër të kompensimit për përkujdesje dhe ndihmë tjetrit për periudhën nga data 01.01.2000 deri me dt. 28.02.2003 në shumë prej 2.872,00 euro, me kamatë të cilën Banka e Re Kosovës e paguan për mjetet e destinuar për 12 muaj nga data 01.10.2001 e deri me pagesën e plotë.

III. në emër të rentës mujore në të ardhmen shumën prej 90,00 euro në muaj në çdo të 1-rë deri të 5-të të muajit duke filluar nga data 01.03.2003 e tutje deri sa të mos krijohen kushtet për ndryshimin e këtij vendimi, ashtu që shumat e arritura të paguhen sipas kamatës të cilën Banka e Re e Kosovës e paguan pas arritjes të çdo kërkesë individuale deri te pagesa e plotë.

IV. në emër të kompensimit për përkujdesje dhe ndihmë tjetrit shumën prej 74,00 euro në muaj në çdo të 1-rë e deri të 5-të të muajit, duke filluar nga data 01.10.2001 e tutje deri sa mos krijohen kushtet për ndryshimin e këtij vendimi, ashtu që shumat e arritura të paguhen sipas kamatës të cilën Banka e Re e Kosovës e paguan pas arritjes të çdo kërkesë individuale deri te pagesa e plotë, që të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarimit me dhunë.

Gjykata e Qarkut në Prishtinë me aktgjykimin me numër Ac.nr.276/2003 i datës 30.01.2004, e ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Komunale të datës 13.03.2003 në pikën III dhe IV të dispozitivit të tij, ndërsa lidhur me rentën e arritur në pikën I dhe II të dispozitivit të aktgjykimit, çështjen e ka kthyer në rigjykim dhe rivendosje, me sugjerimin që të sqarohet pretendimi se lidhur me të njëjtën çështje është paraqitur edhe një padi tjetër.

Gjykata Komunale në Prishtinë me aktgjykimin me numër C.nr.260/04 i datës 25.05.2004, përsëri e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit sikurse me aktgjykimin paraprak, duke i njohur të drejtën paditësit në rentën e arritur për pagesë në periudhën 01.01.2000 deri më datë 28.02.2003.

Ndërsa, Gjykata e Qarkut në Prishtinë me aktvendimin me numër C.nr.121/2005 i datës 05.09.2007, ka prishur aktgjykimin e lartcekur dhe përsëri çështjen e ka kthyer në rigjykim dhe rivendosje, me sugjerimin për të sqaruar se nëse për këtë çështje është vendosur nga Gjykata Supreme lidhur me revizionin e vitit 1997, një kopje e të cilit gjendet në shkresa të lëndës.

Pretendimet e palëve, administrimi i provave dhe gjendja faktike

Në rivendosje, sipas rekomandimeve të aktvendimit të lartcekur nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë, Gjykata Themelore në Prishtinë, ka caktuar dhe ka mbajtur seancat gjyqësore në të cilat janë deklaruar të autorizuarit e palëve ndërgjyqëse.

Paditësi dhe i autorizuari i tij në seanca gjyqësore ka deklaruar se deri në janar të vitit 2000 i është paguar kompensimi në emër të rentës nga e paditura në mënyrë të rregullt sipas aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë me numër 850/96 i datës 15.01.1997. Ndërsa, nga janari i vitit 2000 për shkak të ndërrimit të valutës nga dinari në marka e pastaj nga marka në euro për një periudhë kohore e paditura nuk ka përmbushur kompensimin e caktuar me vendim gjyqësor. Ka shtuar se kompensimin e caktuar me vendim të gjykatës ka rifilluar të marr në mars të vitit 2003 dhe atë në shumë prej 164.00 euro, të cilën shumë e merr edhe tani. Më tutje ka deklaruar se, pasi që kanë ndryshuar rrethanat nga ajo periudhë dhe ka pasur inflacion e njëkohësisht edhe rënie të vlerës së parasë, shuma e caktuar si kompensim në emër të rentës nuk është adekuate me rrethanat e tashme dhe nuk është e mjaftueshme për të plotësuar nevojat që me një shumë të tillë plotësoheshin në nxjerrjen e vendimit gjyqësor. Gjykatës i ka propozuar që për të përlllogaritur shumën e mbetur nga e paditura për periudhën e lartpërmendur, si dhe vlerësimin për rritjen e shumës së rentës së rregullt në emrin tim dhe rentës në emër dhe përkujdesje nga personi tjetër, për periudhën nga paraqitja e padisë në gjykatë e deri me tani të nxjerr ekspertizë nga lëmia e financave.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, përmes parashtrësës ka propozuar ndryshimin e padisë dhe kërkesës së saj, përmes të cilës ka kërkuar:

Të detyrohet e paditura K. që paditësit në emër të rentës mujore të arritur për periudhën nga data 01.01.2000 deri me datën 28.02.2003 t'ia paguaj shumën prej 3,502.00 euro dhe në emër të kompensimit për përkujdesje dhe ndihmë tjetrit për periudhën nga data 01.01.2000 deri me datën 28.02.2003 t'ia paguaj shumën prej 2,872.00 apo shumën e përgjithshme prej 6,374.00 euro sipas kamatës e cila vlen për mjetet e depozituara në bankë me tepër se një vit pa destinim të caktuar nga data 13.03.2003 e deri në pagesën e tërësishme, e të gjitha në afat prej 15 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

T'i njihet e drejta e shpërblimit në lartësi prej 58,899.75 euro, e arritur si rrjedhojë e ndryshimit të rrethanave ekonomike nga periudha e paraqitjes së padisë me datë 08.10.2001 deri me 31.10.2023 dhe atë 32,362.50 euro për rentën vijuese dhe 26,537.25 euro për përkujdesje të personit tjetër, dhe të

Ndryshohet Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë C.nr.986/01 i datës 13.03.2003 dhe të detyrohet e paditura K. që paditësit t'ia paguaj në emër të kompensimit të rentës vijuese në të ardhmen, në lartësi prej 324.75 euro në muaj si dhe kompensimin në emër të përkujdesjes nga personi tjetër në të ardhmen, në lartësi prej 266.30 euro në muaj, duke filluar nga data 22.02.2024, dhe atë çdo muaj deri me datën 5 të muajit, për muajin paraprak, deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore.

Ndërsa në fjalën përfundimtare, gjykatës i ka propozuar që padia e paditësit të aprovohet në tërësi e bazuar sipas ndryshimit dhe precizimit të bërë në seancën e shqyrtimit kryesor.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

I autorizuari i të paditurës ka deklaruar se si palë e paditur jemi duke vepruar konform vendimeve gjyqësore C.nr.986/01 datës 13.03.2003, i aprovuar pjesërisht dhe i ndryshuar me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut Ac. nr. 276/2003, me të cilin jemi të obliguar sipas këtyre vendimeve që paditësit t'ia paguajmë rentën mujore dhe për përkujdesje nga presoni i tretë në shumën prej 164.00 euro, e sipas këtyre vendimeve dhe ekspertizës financiare të datës 15.02.2003, jemi të obliguar që të vijojmë pagesën e kësaj shume prej datës 01.03.2003 e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore. E paditura nuk ka ndonjë vendim të formës së prerë të gjykatave në kohën para luftës me të cilin jem të obliguar që ndaj paditësit të kryejmë pagesën apo obligimin siç pretendon paditësi me padi, e po ashtu as paditësi nuk ka ofruar dëshmi lidhur me këtë kontest. Ka shtuar se, sa i përket propozimit për nxjerrje e ekspertizës së re lidhur me përllogaritje e devalvimit të valutës për kohën kontestuese, konsiderojmë se një ekspertizë e tillë tani për tani është e pa nevojshme për faktin se tani e kemi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të datës 30.01.2004, e po ashtu paditësi është dashur të paraqes një kërkesë tek e paditura lidhur me rritjen e rentës duke e paraqitur edhe arsye dhe dëshmi të qarta për një rritje të tillë, e më pastaj të vazhdoj procedurën gjyqësore në gjykatë.

Më tutje ka shtuar se, në lidhje me vendimin e gjykatës Supreme të Serbisë, sa i përket revizionit P.br. 850/96, në arkivat tona nuk posedojmë një vendim të tillë dhe meqenëse gjykata konstatoj se janë konsumuar mundësit për të gjetur një vendim të tillë, nuk kemi propozime se si mund të sigurojmë të njëjtin.

Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga provat e administruara paditësit i mungon baza juridike e kërkesëpadisë lidhur me kërkesën për periudhën 2000-2003, e po ashtu edhe për kërkesën për rritje të rentës. Ka shtuar se e paditura është duke përmbushur detyrimin e saj sipas vendimeve gjyqësore, ndërsa sa i përket periudhës kontestuese 2000-2003 gjykata nuk ka arritur të siguroj prova lidhur me vendosjen sipas revizionit e për këtë arsye konsideron se padia dhe kërkesa e saj për këtë periudhë duhet të refuzohet në tërësi e pa bazuar për faktin se gjykata tani

për tani nuk mund të vendos për këtë çështje. Kurse, në raport me kërkesën për rritje të rentës nga viti 2000 e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore, ka shtuar se është një kërkesë e parashkuar në kuptim të dispozitave të LMD-së dhe të Ligjit të Punës, për faktin që nuk mund të bëhet një kërkesë në vitin 2023 për rritje të rentës nga viti 2000 e tutje. Po ashtu, paditësi nuk ka shtjerrur rrugët e brendshme administrative për të kërkuar një rritje të rentës sipas ndryshimit socio ekonomik, por në këtë rast ka bërë një hap të gabuar duke kërkuar nga gjykata që të aprovoj një kërkesë të tillë. Andaj, mbi bazën e të lartcekurave, gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesën e saj të refuzoj në tërësi si të pa bazuar, e po ashtu të refuzoj edhe rritjen e rentës si dhe në emër të përkujdesjes nga personi i tretë si të parashkuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 22.02.2024 sipas propozimit të palëve ndërgjyqëse me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, ka administruar provat: aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë me nr. 850/96 i datës 15.01.1997, aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë me nr. 947/97 i datës 13.11.1997, revizioni i datës 23.12.1997 me nr. 6205, kërkesa për pagesën e rentës dhe humbjes së aftësive për punë e paraqitur nga paditësi në drejtim të paditurës me datë 30.08.2000, përgjigje nga Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës e datës 26.09.2022, raporti mbi aprovimin e shpenzimeve i lëshuar nga e paditura K. së bashku me pagesën e rentës i datës 13.01.2023, përgjigje nga Gjykata Supreme e Serbisë së bashku me email-in sqarues i datës 13.07.2023, përgjigje nga Gjykata Komunale në Prishtinë e datës 25.06.2011, përgjigje nga Gjykata e Apelit e Kosovës e datës 06.01.2016, përgjigje nga Gjykata Supreme e Kosovës e datës 08.12.2011, ekspertiza financiare e datës 15.02.2003 dhe ekspertiza financiare e datës 15.11.2023.

Gjykata pas vlerësimit të provave, në përputhje me nenin 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundimin se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga deklaratimet e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, gjykata konstatoj se në mes të palëve nuk ishte kontestuese se paditësi është duke realizuar të hyrat sipas aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë C.nr.986/01 i datës 13.03.2003, lidhur me rentën mujore në shumën prej 90,00 euro dhe në emër të kompensimit për përkujdesje dhe ndihmë tjetrit shumën prej 74,00 euro në muaj.

Mirëpo, kontestuese në mes të palëve ishte pretendimi i palës paditëse lidhur me pagesën e rentës së arritur nga data 01.01.2000 deri më datë 28.02.2003 në shumën prej 3.502,00 euro dhe pagesa në emër të kompensimit për përkujdesje dhe ndihmë tjetrit për periudhën nga data 01.01.2000 deri me datë 28.02.2003 në shumë prej 2.872,00 euro, pagesa e shumës 58,899.75 euro e kërkuar në emër të ndryshimit të rrethanave ekonomike nga periudha e paraqitjes së padisë me datë 08.10.2001 deri me datë 31.10.2023 si dhe ndryshimi i rentës vijuese në të ardhmen, duke filluar nga muaji Nëntor 2023 e tutje në lartësi prej 324.75 euro në muaj si dhe në shumën mujore për kompensimin e përkujdesjes nga personi tjetër në të ardhmen, duke filluar nga muaji Nëntor 2023 e tutje në lartësi prej 266.30 euro në muaj.

Nga aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë i datës 15.01.1997 me numër C.nr.850/96, gjykata konstaton se përmes këtij aktgjykimi paditësit i është aprovuar pjesërisht kërkesëpapia, duke e ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë i datës 12.04.1995 me numër P.nr.1100/94, në raport me rentën e gjykuar dhe në emër të kujdesit dhe ndihmës nga personi tjetër. I njëjti aktgjykim është vërtetuar përmes aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë me numër Ac.nr. 947/97 i datës 13.11.1997, dhe nga ky aktgjykim gjykata konstaton se bazë për caktimin e lartësisë së rentës, kanë qenë të dhënat përkatëse nga Enti Statistikor i Kosovës mbi të ardhurat mesatare të realizuara në bujqësi.

Përmes raportit mbi aprovimin e shpenzimeve të lëshuar nga e paditura K. së bashku me pagesën e rentës e datës 13.01.2023, gjykata konstaton se paditësi gjendet në këtë raport dhe pagesa e përcaktuar për pagesën e rentës është në shumën prej 160.64 euro.

Nga kërkesa për pagesën e rentës dhe humbjes së aftësive për punë e paraqitur nga paditësi në drejtim të paditurës me datë 30.08.2000, gjykata konstaton se paditësi i është drejtuar të paditurës për pagesën e rentës së gjykuar, e po ashtu, me këtë kërkesë ka kërkuar edhe ndryshimin e rentës mbi bazën e ndryshimit të rrethanave ekonomike.

Nga përgjigja e Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës e datës 26.09.2022, gjykata konstaton se aktgjykimi C.nr.850/96 nuk gjendet në ruajtje në këtë institucion. Ndërsa, nga përgjigja e Gjykatës Supreme të Serbisë e datës 13.07.2023, gjykata konstaton se në arkivin e kësaj gjykate nuk gjenden lëndët e vitit 1996.

Përmes përgjigjes nga Gjykata Komunale në Prishtinë e datës 25.06.2011, përgjigjes nga Gjykata e Apelit e Kosovës e datës 06.01.2016, dhe përgjigja nga Gjykata Supreme e Kosovës e datës 08.12.2011, gjykata konstaton se në arkivat e këtyre gjykatave nuk gjendet lënda me numër C.nr.850/96.

Nga ekspertiza financiare e datës 15.02.2003, e përgatitur nga eksperti financiar gjyqësor, gjykata konstaton se shuma lidhur me kompensimin e rentës së rregullt për periudhën 01.01.2000 deri me datë 28.02.2003 është në lartësi prej 3,502.44 euro, ndërsa, shuma lidhur me kompensimin e rentës në emër të përkujdesjes dhe ndihmës nga tjetri për periudhën 01.01.2000 deri me datë 28.02.2003 është në lartësi prej 2,872.20 euro.

Ndërsa, nga ekspertiza e datës 15.11.2023, gjykata konstaton se shuma sipas kërkesës së paditësit si rrjedhojë e ndryshimit të rrethanave ekonomike, përgjatë periudhës 08.10.2001 kur është parashtruar padia në gjykatë e deri me datë 31.10.2023, lidhur me rentën vijuese është në lartësi prej 32,362.50 euro, ndërsa në emër të përkujdesjes të personit të tretë është në lartësi prej 26,537.25, në shumën e përgjithshme prej 58,899.75 euro. Kurse, lidhur me kërkesën e paditësit për rentën vijuese për të ardhmen, gjerë sa të mos ndryshojnë rrethanat ekonomike, duke filluar nga muaji nëntor e tutje, gjykata konstaton se eksperti ka rekomanduar shumën prej 324.75 euro, ndërsa në emër të kompensimit për përkujdesjen e personit të tretë, për të ardhmen, duke filluar nga muaji nëntor e tutje, eksperti ka rekomanduar shumën prej 266.30 euro në muaj.

Fillimisht, gjykata mori për bazë sugjerimit e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë të dhëna përmes aktvendimit të datës 05.09.2007, me të cilin aktvendim kjo çështje është kthyer në rigjykim, duke rekomanduar që të kërkohet informacion nga Gjykata Supreme e Kosovës, lidhur me revizionin e paraardhëses së të paditurës i cili është paraqitur në gjykatën e shkallës së parë me datë 26.12.1997 kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë me numër Ac.nr.974/97 i datës 13.11.1997, me të cilin është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë me numër C.nr.850/96 i datës 15.01.1997, dhe kjo pasi që në shkresa të lëndës gjendet kopja e revizionit të paraardhëses së të paditurës e cila është regjistruar në numrin rendor 9 dhe pastaj duke rekomanduar që varësisht nga gjendja e konstatuar faktike të vendoset drejtë dhe në mënyrë meritore lidhur me këtë çështje kontestimore.

Duke vepruar sipas sugjerimeve të dhëna nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë, gjykata në ri procedurë i është drejtuar Gjykatës Supreme të Kosovës, Gjykatës së Apelit të Kosovës, Gjykatës Komunale në Prishtinë, Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, ndërsa, i autorizuarit i paditësit i është drejtuar edhe Gjykatës Supreme të Serbisë, dhe nga përgjigja e të gjitha këtyre institucioneve, gjykata konstatoj se nuk ekziston ndonjë e dhënë lidhur me vendosjen ose jo sipas revizionit, i cili gjendet në shkresa të lëndës. Lidhur me këtë edhe të autorizuarit e palëve ndërgjyqëse në seanca gjyqësore kanë deklaruar se nuk kanë njohuri nëse është vendosur apo jo nga Gjykata Supreme e asaj kohe lidhur me revizionin.

Renta e arritur për pagesë për periudhën 01.01.2000 deri me datë 28.02.2003

Pasi që gjykata, i ndërmori të gjitha veprimet për të konstatuar lidhur me atë nëse është vendosur apo jo për revizionin dhe në mungesë të sigurimit të informatave, gjykata në rastin konkret vlerësoj se duhet të zbatohet neni 322 paragraf 3 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (tani e tutje LPK) i cili parasheh: *“Pala e cila e konteston ekzistimin e ndonjë të drejte e bartë barrën e të provuarit të faktit që e ka penguar krijimin apo realizimin e saj, ose në bazë të të cilit ka pushuar se ekzistuari, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër.”* Bazuar në këtë dispozitë, duke marr për bazë faktin se e paditura e ka kontestuar kërkesën lidhur me pagesën e rentës së arritur për periudhën 01.01.2000 deri me datë 28.02.2003, gjykata konstatoj se e paditura e bartë barrën e të provuarit në rastin konkret lidhur me revizionin, për çka e paditura nuk ka ofruar asnjë provë lidhur me atë nëse ndonjëherë është vendosur apo jo për këtë revizion nga Gjykata Supreme.

Meqenëse, e paditura në seanca gjyqësore e ka pohuar se pagesa nuk është kryer për periudhën 01.01.2000 deri me datë 28.02.2003, me arsyetimin se nuk kanë njohuri se si është vendosur për revizionin, gjykata konstatoj se pagesa për këtë periudhë nuk është përmbushur asnjëherë. Ndërsa, në anën e kundërt paditësi në seancën e shqyrtimit kryesor, ka deklaruar se e paditura deri në janar të vitit 2000 i ka paguar kompensimin në emër të rentës në mënyrë të rregullt, sipas aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë me numër 850/96 i datës 15.01.1997.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata e aprovoj kërkesën e paditësit, sikurse në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke marr për bazë faktin se paditësi ka krijuar bazën me aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë C.nr.850/96 i datës 15.01.1997, i vërtetuar nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë me numër Ac.nr.974/97 i datës 13.11.1997, ku e paditura ishte obliguar të paguajë

shumën në dinarë, e cila shumë sipas ekspertizës financiare të datës 15.02.2003, është konvertuar në euro, sipas lartësisë sikurse në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit. Lidhur me këtë ekspertizë, eksperti financiar ka dhënë sqarimet e nevojshme në seancën e shqyrtimit kryesor, për çka gjykata këtë ekspertizë e trajtoj si profesionale, e hartuar në përputhje me detyrat e ekspertit, dhe në bazë të së njëjtës e konstatoj shumë për të cilën obligohet e paditura të përmbush në raport me paditësin.

Renta vijuese e njohur nga data 22.02.2024 e tutje

Në raport me pikën III të dispozitivit të aktgjykimit, gjykata vlerësoj se duhet të detyrohet e paditura K. që paditësit t'ia paguaj në emër të kompensimit të rentës vijuese në të ardhmen, shumë në lartësi prej 324.75 euro në muaj si dhe kompensimin në emër të përkujdesjes nga personi tjetër në të ardhmen, shumë në lartësi prej 266.30 euro në muaj, duke filluar nga paraqitja e kërkesës me datë 22.02.2024, dhe atë çdo muaj deri me datën 5 të muajit, për muajin paraprak.

Lidhur me këtë kërkesë, gjykata fillimisht thekson se në këtë çështje nuk është trajtuar e drejta në raport me rentën, kjo për faktin se një e drejtë e tillë është njohur paraprakisht përmes aktgjykimit i cili ka marr formën e prerë, mirëpo, është trajtuar vetëm aspekti i asaj nëse plotësohen kushtet ligjore për ndryshimin e saj.

Në lidhshmëri me këtë, gjykata vlerësoj se duhet të zbatohen dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve i vitit 1978, i cili Ligj në nenin 196 parasheh ndryshimin e kompensimit të gjykuar, sipas të cilit: *“Gjykata mundet me kërkesë të dëmtuarit, që në të ardhmen ta shtojë rentën por me kërkesën e dëmtuesit zvogëlojë ose ta heq në qoftë se kanë ndryshuar esencialisht rrethanat për të cilat gjykata ka pasur parasysh me rastin e nxjerrjes së vendimit.”* Bazuar në këtë dispozitë, lejohet mundësia që gjykata, rentën në të holla të gjykuar më herët, me kërkesë të dëmtuarit, të rritë për të ardhmen, në rast se rrethanat në bazë të cilave është vendosur më herët me vendimin e mëparshëm, kanë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme. Në lidhshmëri me këtë, gjykata thekson se për ndryshimin e shpërblimit të gjykuar në formë të rentës duhet të plotësohen dy kushte esenciale, dhe atë: legjitimiteti për njohjen e një të drejtë të tillë dhe ndryshimi i rrethanave në bazë të cilave është vendosur më herët me vendimin e mëparshëm, nëse të njëjtat kanë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme.

Lidhur me legjitimitetin aktiv për të kërkuar një të drejtë të tillë, gjykata vlerëson se paditësi është i legjitimuar për të kërkuar këtë të drejtë, për faktin se vet paditësi ka qenë i dëmtuar, përkatësisht ka pësuar lëndime në vendin e punës tek e paditura, dhe kjo është konstatuar nga aktgjykimet paraprake të lartcekura, dhe e njëjta nuk ishte kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse.

Në vijim, çështje për sqarim mbetet kushti i dytë, përkatësisht ndryshimi i rrethanave në bazë të cilave është vendosur më herët me vendimin e mëparshëm, nëse të njëjtat kanë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme.

Meqenëse, sipas të lartcekurave, kusht për të vendosur që shuma e shpërblimit të rritet, është ndryshimi i rrethanave në mënyrë të konsiderueshme, të cilat gjykata i ka pasur parasysh me rastin e marrjes së aktgjykimit të mëparshëm, lidhur me këtë, gjykata e vlerësoj dhe analizoj aktgjykimin C.nr. 986/01 i datës 13.03.2003 i vërtetuar nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë me aktgjykimin me numër Ac.nr.276/2003 i datës 30.01.2004, me të cilin aktgjykim ishte ndryshuar dhe shfuqizuar aktgjykimi C.nr. 850/96 i datës 15.01.1997 dhe i njëjti i ka njohur paditësit ndryshimin në emër të rentës mujore për të ardhmen dhe në emër të kompensimit për përkujdesje dhe ndihmë tjetrit. Nga ky aktgjykim, gjykata konstatoj se bazë për caktimin e lartësisë së rentës, kanë qenë të dhënat përkatëse nga Enti Statistikor i Kosovës mbi të ardhurat mesatare të realizuara në bujqësi. Me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, gjykata në tërësi ishte bazuar në ekspertizën e ekspertit financiar gjyqësor, përkatësisht në ekspertizën e datës 15.02.2003.

Mbi këtë bazë, gjykata në këtë procedurë, sipas propozimit të paditësit përmes ekspertit financiar ka nxjerr ekspertizën financiare, e cila ekspertizë është përgatitur duke u bazuar mbi të dhënat, dhe atë: të ardhurat mesatare për vitet 10/2001 – 2002, të ardhurat mesatare (pagat) në Kosovë nga viti 2003 – 2007 (vjetari statistikor), të ardhurat mesatare (pagat) në Kosovë nga viti 2008 – 10/2023 (vjetari statistikor), renta e realizuar nga paditësi 10/2001 – 10/2023 (kartela e qarkullimit bankar), realizimi nga paditësi për përkujdesje të personit tjetër 10/2001 – 10/2023 dhe shkallën e paaftësisë së aktivitetit jetësor (75%) për paditësin (kartela e qarkullimit bankar). Bazuar mbi këto të dhëna, e mbi bazën e të ardhurave mesatare në Kosovë, eksperti financiar ka arritur në përfundim se shuma e rentës mujore për të ardhmen është në shumën 324.75 euro dhe shuma mujore për përkujdesjen e personit tjetër në të ardhmen është 266.30 euro. Eksperti financiar në seancën e shqyrtimit kryesor, ka dhënë sqarimet e nevojshme në raport me ekspertizën, duke i 'u përgjigjur edhe pyetjeve të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse.

Gjykata e vlerësoj dhe e analizoj ekspertizën e lartcekur, dhe konstatoj se e njëjta është hartuar në përputhje me detyrat e propozuara nga paditësi e të aprovuara nga ana e gjykatës, dhe si e tillë i përmban të dhënat e nevojshme, të sqaruara në mënyrë të mjaftueshme, për çka gjykata të njëjtën e trajtoj si të pranueshme dhe profesionale.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata konstatoj se me kalimin e kohës, kanë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme rrethanat të cilat kanë qenë vendimtare me rastin e caktimit të lartësisë së rentës me vendimin paraprak, dhe në lidhshmëri me këtë, plotësohen kushtet për të ndryshuar aktgjykimin paraprak ashtu siç përcaktohet me dispozitën e lartcekur të nenit 186 nga Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Në lidhshmëri me këtë, si rrethanë vendimtare të ndryshuar gjykata i konsideron të ardhurat mesatare ndër vite, dhe atë sipas ekspertizës së lartcekur.

Gjykata rithekson se e drejta në realizimin e rentës vijuese është formë e veçantë e shpërblimit të dëmit, nëpërmjet së cilës bëhet shpërblimi i dëmit material, i cili duhet të realizohet në të ardhmen. Gjykata sikurse në dispozitiv e caktoj shumën fikse të pagesës, se pagesa duhet të kryhet çdo muaj, dhe atë deri me datën 5 të muajit për muajin paraprak, ashtu siç parashihet me nenin 188 paragraf 2 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, i cili përcakton: *“Renta në të holla e gjykuar për efekt të kompensimit të dëmit paguhet për çdo muaj përpara, në qoftë se gjykata nuk cakton diçka tjetër.”*

Me rastin e vendosjes lidhur me këtë kërkesë, gjykata e kishte parasysh faktin se në këtë procedurë, është vendosur lidhur me rentën vijuese me aktgjykimin C.nr. 986/01 i datës 13.03.2003 i vërtetuar nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë me aktgjykimin me numër Ac.nr.276/2003 i datës 30.01.2004, mirëpo, gjykata vlerësoj se meqenëse pikat III dhe IV të këtij aktgjykimi lidhur me këtë pjesë kanë marr formën e prerë, në përputhje me nenin 166 paragraf 1 të LPK-së, i cili parasheh: *“Aktgjykimi i cili nuk mund të goditet me anë të ankesës bëhet i formës së prerë për aq sa është vendosur me të mbi kërkesëpadinë apo të kundërpadisë.”* gjykata ketë aktgjykim e konsideroj si të pavarur dhe vlerësoj se nuk paraqitën pengesa për të ndryshuar të njëjtin në këtë procedurë.

Refuzimi i kërkesës lidhur me rentën e arritur nga 08.10.2001 deri me 31.10.2023

Në raport me pikën IV të dispozitivit, me të cilën është refuzuar si e pa bazuar kërkesa e paditësit me të cilën ka kërkuar që t’i njihet e drejta e shpërblimit në lartësi prej 58,899.75 euro, e arritur si rrjedhojë e ndryshimit të rrethanave ekonomike nga periudha e paraqitjes së padisë me datë 08.10.2001 deri me 31.10.2023 dhe atë 32,362.50 euro për rentën vijuese dhe 26,537.25 euro për perkujdesje të personit tjetër, dhe lidhur me këtë, gjykata fillimisht e vlerësoj kohën e paraqitjes së kërkesës së paditësit.

Paditësi me rastin e paraqitjes së padisë në gjykatë me datë 08 Tetor 2001 kishte kërkuar ndryshimin e aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë C.nr. 850/96 të datës 15.01.1997, me pretendimin se kanë ndryshuar rrethanat ekonomike, nga koha e nxjerrjes së këtij aktgjykimi. Lidhur me këtë kërkesë, në këtë procedurë, gjykata i kishte njohur të drejtën paditësit me aktgjykimin C.nr.986/01 i datës 13.03.2003 i cili kishte marr edhe formën e prerë. Dhe tani, siç është theksuar edhe me lartë, në rigjykim ishte kthyer vetëm kërkesa lidhur me rentën e arritur për periudhën 01.01.2000 deri me datë 28.02.2003.

Paditësi në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 22.02.2024, për herë të parë kishte paraqitur kërkesë për rentën vijuese, kjo për faktin se deri në këtë seancë, paditësi kishte qëndruar prapa padisë fillestare të paraqitur në gjykatë me datë 08.10.2001, e cila rentë vijuese tani më ishte gjykuar në këtë procedurë, siç është theksuar me lartë me aktgjykimin C.nr. 986/01 i datës 13.03.2003, dhe deri në këtë fazë, nuk rezulton që është paraqitur kërkesë për ndryshimin e këtij aktgjykimi të fundit lidhur me rentën vijuese.

Lidhur me këtë, neni 196 i Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve sa i përket ndryshimit të kompensimit të gjykuar, përcakton se: *“Gjykata mundet me kërkesë të dëmtuarit, që në të ardhmen ta shtojë rentën por me kërkesën e dëmtuesit zvogëlojë ose ta heq në qoftë se kanë ndryshuar esencialisht rrethanat për të cilat gjykata ka pasur parasysh me rastin e nxjerrjes së vendimit.”* Bazuar në këtë dispozitë, gjykata vlerëson se, me kërkesë të dëmtuarit, mund të ndryshohet renta e gjykuar vetëm për të ardhmen. Rrjedhimisht, në përputhje me këtë dispozitë, gjykata vlerëson se i dëmtuari ka të drejtën e rritjes së rentës vetëm nga dita e paraqitjes së padisë apo kërkesës për ndryshimin, respektivisht rritjen e rentës, me çka gjykata vendosi që një kërkesë e tillë të refuzohet sikurse në pikën IV të dispozitivit, për faktin se kërkesa është paraqitur në seancën e shqyrtimit kryesor me datë 22.02.2024.

Kamata ligjore

Sa i përket kamatës sikurse në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, gjykata vendosi që e njëjta të paguhet sikurse për mjetet e depozituara në bankë me tepër se një vit pa destinim të caktuar nga data 13.03.2003 e deri në pagesën e tërësishme. Gjykata vlerëson se kamata lidhur me rentën mujore fillon të rrjedhë nga arritja e secilës kërkesë veç e veç, pavarësisht nga dita se kur kërkohet mbrojtje gjyqësore ose kur behët vlerësimi i kërkesave të arritura, mirëpo në rastin konkret, paditësi kamatën e kishte kërkuar nga data 13.02.2003, me çka gjykata vendosi brenda kërkesës së tij.

Shpenzimet e procedurës

Vendimin që secila nga palët të bartë për vete shpenzimet e procedurës, gjykata e bazoj në faktin se sipas vendimit në shkresa të lëndës me nr. 206/23-01 i datës 05.07.2023 i autorizuari i paditësit ishte i caktuar nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, dhe bazuar në nenin 36 të Ligjit Nr. 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas, shpenzimet e kësaj Agjencie, mbulohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës. Andaj, bazuar në nenin 450 të LPK-së, gjykata vendosi sikurse në pikën V të dispozitivit të aktgjykimit.

Bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në pajtim me dispozitat e nenit 142 dhe 143 të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr. 2013/2007, datë 26.03.2024

Gjyqtari
Argzon Muçaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi, pranë Gjykatës së Apelit të Kosovës me seli në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme.